



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 40/01-16026 dt. 29/03/ 2024



Bazuar në nenin 11,12,dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 5 pika 1.3 e Ligjit nr.04/L-012 Për Mbrojtje nga Zjarri, neni 37 pika 2, paragrafët 2.2 dhe 2.5, neni 44 pika 3 e Ligjit Nr. 04/L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 29.03.2024, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Drenasit miratoj vazhdimin e afatit të zbatimit të Planit për Vlerësimin e Rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit, 2021-2023, deri në hartimin e Planit të Ri të Vlerësimit të Rrezikshmërisë.

Neni 2

Plani i ri i Vlerësimit të Rrezikut për territorin e Komunës së Drenasit, do të bëhet nga Komisioni i caktuar me Vendim nga Kryetari i Komunës dhe i njëjti do të paraqitet para Kuvendit për miratim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi, kujdeset Kryetari i Komunës.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit




Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Milaim Hajdari

ARSYETIM

Pas hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, Planeve Rregulluese Urbane dhe Hartës Zonale për Komunën e Drenasit, është shtruar nevoja edhe për shqyrtimin e Planit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë për territorin e Komunës së Drenasit, që të dhënat në këtë plan të jenë të njëjta si në planet e lartshënuara, sepse, ka pasur ndryshime në ndërtime, infrastrukturë përcjellëse (rrugë, trotuare, ujësjellës, kanalizim, ndriçim) e të tjera.

Një dokument i tillë u drejtohet me propozimin për miratimin e tij duke marrë parasysh faktin se sipas legjislacionit në fuqi, Kryetari i Komunës obligohet që së bashku me mendimin e tij të njëjtin ta dorëzojë në Kuvendin e Komunës për shqyrtim dhe miratim.



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Milaim Hajdari, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MPB-së	
Nga:	Jeton Qela, U. d Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Data: 16.04.2024
Zyrtarët përgjegjës:	Erbilin Hetemi, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	VI-020-245
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 02 Nr. 400/01-16026 për vazhdimin e afatit të zbatimit të Planit për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Glllogocit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ashtu e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme,

Bashkangjitur gjeni vlerësimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme.